



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr.116/1 prot.

Shkodër, më 9 2.2023

LËNDA: Mbi vendimin Nr.4 datë 25.01.2023 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës.

KËSHILLIT BASHKIAK VAU-DEJES


Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016 dt. 2.10.2016 “Për Prefektin”, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”si dhe aneksi 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Kreu II, neni 4, në mbështetje të nenit 9, pika 1/1.2 germa a dhe c, nenit 27 pika 5, nenit 54 shkronja e/1, nenit 55 pikat 3 të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, ligjit Nr.9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor publik” i ndryshuar, ligjit Nr.57/2020 “Për pyjet”, VKM Nr.686 datë.2.09.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.433 datë 8.06.2016 të këshillit të ministrave “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike”, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrise së Mjedisit e të ish/komunave /bashkive të ndryshuar”, Kreu II, pika 2 e Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.2, datë 20.07.2016 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”, shqyrtoi **VKB Vau-Dejës Nr.4, datë 25.01.2023 “Për miratimin e listës së kullotave të gatshme për kullotje dhe kositje bari”.**

Pas analizimit, Prefekti ju autorizon procedim konform procedurave të mëtejshme ligjore të parashikuara në legjislacion.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

VENDIM

Nr. 04 datë 25.01.2023

Për miratimin e listës së kullotave të gatëshme për kullotje dhe kositje Bari dhe e pyjeve që kulloten.

Në mbështetje të nenit 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja "el", të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligji nr 9693 dt 19.03.2007 i ndryshuar "Për fondin kullosor publik" neni 17, ligji 57/2020 datë 30.04.2020 neni 25. **Pika 49** e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, i ndryshuar "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive", Udhëzimit nr. 2, datë 20.07.2016 të Ministrit të Mjedisit "Për kriteret teknikë të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari", Këshilli i Bashkisë Vau-Dejës:

VENDOSI

1. Për miratimin e listës së kullotave të gatshme për kullotje dhe kositje Bari dhe pyjeve që kulloten.
2. Efektet: Jep impaktë pozitive tek komuniteti duke rigjeneruar të ardhura , sigurohen të ardhura tek Bashkia të cilat kthehen në investime në fondin pyjor ,kullosor.
3. Ngarkohen Drejtoria e Pyjeve, Turizmit, dhe Mbrojtjes së Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

KRYETAR
MARK BISHA

Sekretari i Këshillit Bashkiak
ARDIAN ÇELEPIJA

Miratuar me 18 vota

Vota Pro 18

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 27.01.2023